



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1796 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

**VENDIM**

**Nr.251, datë 29.12.2017**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT  
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 172, DATË 19.07.2017,  
NË INSTITUCIONIN E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 19.07.2017 ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit’”,

**KONSTATOVA SE:**

Me Vendimin Nr. 226, datë 08.11.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 172, datë 19/07/2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit’”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur verifikimin e akteve të emërimit, veprimeve administrative të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, prej datës 20.05.2016, e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 172 datë 19.07.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit’”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

2. *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit për punonjësit*

\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*;

\*\*\*\*\*,  
\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, si akte të nxjerra në kundërshtim me nenet 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kapërcim të kompetencave si dhe në kundërshtim me procedurën ligjore.

3. Për rregullimin e paligjshmërisë, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulojë aktin e emërimit nr. 4307, datë 18.10.2016, për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “Specialist”, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 5345, datë 15.12.2016, për punonjësën \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 4183, datë 12.10.2016, për punonjësën \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 122, datë 11.01.2017, për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin nr. 3783, datë 15.09.2016, për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 1854, datë 16.05.2016, për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 5551, datë 04.01.2017, për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë;

- Të anulojë aktin e emërimit nr. 123, datë 11.01.2017, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Elbasan;
  - Të anulojë aktin e emërimit nr. 1994, datë 26.05.2016, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë;
  - Të anulojë aktin e emërimit nr. 5389, datë 19.12.2016, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Berat;
  - Të anulojë aktin e emërimit nr. 3935, datë 28.09.2016, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë”.
4. Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurës Administrative, duhet të anulojë aktin e emërimit nr. 2458/2, datë 04.04.2016, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë”.
5. Pozicionet e mësipërme, të cilat konsiderohen pozicione të lira në kuptim të ligjit, duhet të plotësohen nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
6. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të transferimit (caktimit) të përkohshëm për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* si akte të nxjerra në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

*Për rregullimin e paligjshmërisë së këtyre veprimeve administrative, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duhet të veprojë si më poshtë:*

- Të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 1809, datë 11.05.2015, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë

- Të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 6, datë 08.01.2016, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e saj në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë;
- Të anulojë urdhrin nr. 1920 prot., datë 20.05.2016, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë;
- Të anulojë urdhrin nr. 2457 prot., datë 22.08.2016, për transferimin e nëpunësit \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Durrës dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier;
- Të anulojë urdhrin nr. 3438 prot., datë 18.08.2016, për transferimin e nëpunësit \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë;
- Të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 1600 prot., datë 28.04.2016, për transferimin e nëpunësit \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë së Përgjithshme AKU dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Berat;
- Të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 5 prot., datë 08.01.2016, për transferimin e nëpunësit \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Korçë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Gjirokastrë;
- Të anulojë urdhrin nr. 1680 prot., datë 06.05.2016, për transferimin e nëpunësit \*\*\*\*\*\*, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.

*Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të kujdeset për zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm sipas kërkesave të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke mbajtur parasysh:*

- a) Përcaktimin në akt të afatit (kohëzgjatjes) së transferimit të përkohshëm, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj, në 2 vjet.*
  - b) Marrjen e miratimit nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.*
- 7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të tregojë kujdes që në të ardhmen të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rregullave ligjore për të garantuar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, duke garantuar të drejtat e nëpunësve civilë të cilët ushtrojnë detyrën në këtë institucion, nëpërmjet administrimit të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.*
- 8. Autoriteti Kombëtar i ushqimit, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 172 datë 19.07.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit’’, me Vendimin Nr. 226, datë 08.11.2017, ‘Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 172 datë 19.07.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit prej datës 20/05/2016 deri në momentin e verifikimit’’, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 172 datë 19.07.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Migena Haznedari dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe znj.Enkelejda Hebibasi Drejtore e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 23 dhe 24 Nëntor 2017, u paraqitën pranë institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e AKU-së dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1796/3 prot., datë 08.11.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me Drejtorin e Përgjithshëm të AKU-së dhe Përgjegjës të Burimeve Njerëzore të këtij institucioni dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 23.11.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personi i kontaktit të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

**Në pikat 2 dhe 3 të vendimit,** Komisioneri i ka lënë detyrë Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, që të konstatojë pavlefshmërinë absolute dhe të anulojë aktet e emërimit për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*. Nga verifikimi në subjekt, rezultoi se janë nxjerrë aktet si më poshtë:

- 1- Urdhri nr.4117/2 prot, datë 26.10.2017, “Për ndërprerjen e kontratës së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist”, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.
- 2- Urdhri nr. 4117/2 prot., datë 26.10.2017, “Për ndërprerjen e kontratës së punës”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU (numri i protokollit sipas njësisë së burimeve njerëzore është vendosur gabim, pasi përmban të njëjtin numër me atë më sipër).
- 3- Urdhri nr.4149/2 prot., datë 21.11.2017, “Për ndërprerjen e kontratës së punës”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Elbasan.
- 4- Urdhri nr.4110/4 prot., datë 09.11.2017, “Për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës individuale të punës”, për punonjësin Lorenc Rexho, me detyrë “Drejtore pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë”.
- 5- Urdhri nr. 4160/2 prot., datë 27.10.2017, “Për ndërprerjen e kontratës së punës”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë.
- 6- Urdhri nr.4148/1 prot., datë 27.10.2017, “Për ndërprerjen e kontratës së punës”, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Berat.

- 7- Urdhri nr. 4018/1 prot., datë 11.10.2017, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU, pas kërkesës së tij për dorëheqje nga detyra.
- 8- Urdhri nr. 1416/1 prot., datë 30.03.2017, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU, pas kërkesës së tij për dorëheqje nga detyra.
- 9- Urdhri nr.4217/1 prot., datë 20.10.2017, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë, pas kërkesës së tij për dorëheqje nga detyra.

Nga përmbajtja e akteve të mësipërme, rezulton se për punonjësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* marrëdhënia e punës me institucionin e AKU-së ka përfunduar përpara momentit të verifikimit në subjekt, ndërsa për punonjësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* marrëdhënia e punës do të ndërpritej në datën 30.11.2017 dhe për punonjësen \*\*\*\*\* në datën 31.12.2017, me qëllim për të mos krijuar pengesa në mbarëvajtjen e punës, sikundër u pretendua nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së.

Në të gjitha rastet rezulton se aktet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë nxjerrë bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Duke qenë se marrëdhënia e punësimit në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil rregullohet nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, AKU nuk mund të bazohej për përfundimin e kësaj marrëdhënieje në Kodin e Punës.

Për punonjësin \*\*\*\*\* me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, me aktin nr. 4769 prot, datë 13.11.2017, “*Njoftim*” për ndërprerjen e kontratës së punës ka njoftuar punonjësin për zgjidhjen e kontratës dhe mbajtjen e një seance dëgjimore në datën 17.11.2017. Grupi i punës e ka administruar këtë akt, së bashku me procesverbalin e seancës dëgjimore nr. 4768/1 prot., datë 17/11/2017. Në vijim, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së nuk ka marrë asnjë masë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për këtë punonjës.

Për punonjësen \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në

Drejtorinë e Përgjithshme të AKU, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së nuk ka marrë asnjë masë për kthimin e gjendjes së ligjshmërisë.

**Në pikën 4 të vendimit**, Komisioneri ka kërkuar nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të anulojë aktin e emërimit për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “*Drejtor pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Tiranë*”.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se punonjësi \*\*\*\*\* ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga detyra në datën 10.10.2017. Me Urdhrin nr.4016/2 prot., datë 12.10.2017, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “*Drejtor pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Tiranë*”, Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe asaj financiare në datën 13.10.2017.

Pavarësisht faktit që nga ana e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nuk është marrë asnjë masë për anulimin e aktit të emërimit për punonjësin në fjalë, duke qenë se tashmë situata e ligjshmërisë është vendosur si pasojë e dorëheqjes së tij, kjo pikë e vendimit do të konsiderohet e zbatuar. Në të ardhmen duhet të mbahet parasysht që të zbatohet me përpikmëri ligji dhe rekomandimet e Komisionerit.

**Në pikën 5 të vendimit**, Komisioneri ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, që pozicionet për të cilat është kërkuar anulimi i akteve të emërimit të shpallen si të lira dhe të plotësohen në përputhje me ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Në kushtet e organizimit të ri të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioneve të saj të varësisë, kjo detyrë do të verifikohet në përfundim të procesit të ristrukturimit.

**Në pikën 6 të vendimit** paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të transferimit të përkohshëm dhe të përhershëm për punonjësit \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*; si akte të nxjerra në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 48 të ligjit. Nga verifikimi në subjekt, rezultoi se:

1. Me Urdhrin nr.4349/1 prot., datë 02.11.2017, punonjësi \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm “*Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Pikën e Inspektimit Kufitar pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së Qarku Gjirokastër*”.
2. Me Urdhrin nr.4349/8 prot., datë 02.11.2017, punonjësi \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe operatorëve të Biznesit pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së Vlorë*”.
3. Me Urdhrin nr.4349/12 prot., datë 15.11.2017, punonjësi \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit të*



*mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU”.*

4. Me Urdhrin nr.4349/11 prot., datë 15.11.2017, punonjësi \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm *“Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit pranë DR AKU-së Fier”.*
5. Me Urdhrin nr.4349/10 prot., datë 15.11.2017, punonjësi \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm *“Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit pranë DR AKU-së Vlorë”.*
6. Me Urdhrin nr.4349/7 prot., datë 02.11.2017, punonjësi \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm *“Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit pranë Drejtorisë Rajonale AKU-së Qarku Tiranë”.*
7. Me Urdhrin nr.4349/6 prot., datë 02.11.2017, punonjësja \*\*\*\*\* rikthehet në pozicionin e tij të mëparshëm *“Inspektore në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së Qarku Korçë”.*

Për punonjësin Gerard Hoxha transferuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme AKU nuk është marrë asnjë masë për kthimin e tij në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Berat AKU-së Berat.

## **K o n k l u z i o n i**

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 172, datë 19.07.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016 deri në momentin e verifikimit”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna nga Komisioneri. Pikat 2, 3 dhe 5 të dispozitivit të vendimit do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 172, datë 19.07.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve*

*administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016 deri në momentin e verifikimit”.*

2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3 dhe 5 të Vendimit Nr. 172, datë 19.07.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**